



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 pika b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "A&A&D Kosova" Sh.P.K. të datës 19.04.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 27.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Demontimi, transporti dhe deponimi i Azbestit nga objektet publike" me nr. të prokurimit 616-23-2785-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 070 221, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e palejuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "A&A&D Kosova" Sh.P.K. e datës 19.04.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 27.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Demontimi, transporti dhe deponimi i Azbestit nga objektet publike" me nr. të prokurimit 616-23-2785-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 070 221.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "A&A&D Kosova" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "A&A&D Kosova" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 19.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 27.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Demontimi, transporti dhe deponimi i Azbestit nga objektet publike" me nr. të prokurimit 616-23-2785-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 23 070 221.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se hapja e ofertave për këtë procedurë të prokurimit është përcaktuar me datë 24.04.2023 që njëkohësisht paraqet edhe përfundimit e afatit për dorëzimin e ofertave nga operatorët ekonomik. Siç është cituar edhe më sipër, kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datë 19.04.2023. Kjo nënkupton që është paraqitur në më pak se pesë ditë (5) para përfundimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave nëse data e hapjes së ofertave më 24.04.2023 kalkullohet si dita zero (0).

Përmes nenit 60 paragrafit 60.1 nënparagrafit a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP") përcaktohet se kërkesa për rishqyrtim mund të parashtrohet sipas afatit vijues "*Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzimin të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)*". Bazuar në këtë dispozitë të RRPP mund të nënkuptohet që nëse përjashtojmë datën 24 prill (si datën e hapjes së ofertave) si ditën zero (0), atëherë kërkesa për rishqyrtim nga njoftimit për kontratë nuk mund të parashtrohet brenda intervalit kohor prej pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave që nënkupton se nuk mund të parashtrohet brenda periudhës nga data 19 prill 2023 deri me datën 23 prill 2023 (për datën 24 prill 2023 nuk është fare kontestuese).

Në rastin konkret kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pikërisht brenda kësaj periudhe kohore përkatësisht me datën 19 prill 2023. Kjo nënkupton se ndërmjet datës së kërkesës për rishqyrtim dhe datës së fundit për dorëzimin të ofertave **nuk janë së paku pesë (5) ditë ndërmjet tyre** sikurse kërkohet me RRPP (ndërmjet datës 19 prill dhe datës 24 prill janë vetëm katër ditë ndërmjet përkatësisht datat 20, 21, 22 dhe 23 prill). Rrjedhimisht është gjetur se kjo kërkesë për rishqyrtim është parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafit 60.1 nënparagrafit a) të RRPP.

Përmes nenit 62 paragrafit 62.1 të RRP përcaktohet se "*Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 60.1 të kësaj RRPP*".

Tutje përmes nenit 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) përcaktohet se "*Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me anë të një vendimi, mund të refuzojë kërkesën për shqyrtim sipas Nenit 62 të kësaj rregullore kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlihet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit*".


Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin b) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin a) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin a) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.04.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimin të këtij vendimi.